



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2019-02

Vendosi: Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 7 mars 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

URDHËR

për Parashtruesin për parashtrimin e kundërpërgjigjes

Parashtruesi

Z. Ruzhdi Saramati

GJYKATËSI I VETËM është ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës së parashtruar nga z. Ruzhdi Saramati ("Parashtruesi") më 23 shkurt 2019 ("Kërkesa për rishikim"),¹ për rishikimin e vendimit të Administratores në lidhje me ndihmën juridike, Ref: KSC/REG/IOR/1632, të datës 18 shkurt 2019 ("Vendim në lidhje me ndihmën juridike") dhe në vijim lëshon këtë urdhër për Parashtruesin lidhur me parashtrimin e kundërpërgjigjes.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 janar 2019, Parashtruesi i dorëzoi Administratores Kërkesë për ndihmë juridike ("Kërkesa për ndihmë juridike").² Më 18 shkurt 2019, Administratorja nxori vendimin në lidhje me ndihmën juridike për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike.³
2. Më 23 shkurt 2019, Parashtruesi dorëzoi kërkesën për rishikim, e cila u mor nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës më 25 shkurt 2019.⁴ Më 26 shkurt 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës caktoi një gjykatës të vetëm për rishikimin e vendimit në lidhje me ndihmën juridike.⁵
3. Më 27 shkurt 2019, gjykatësi i vetëm lëshoi një urdhër për Administratoren, për dërgimin e dokumenteve që kanë të bëjnë me vendimin në lidhje me ndihmën juridike, si dhe për parashtrimin e përgjigjes ndaj kërkesës për rishikim deri më 7

¹ KSC-BC-2019-02, F00001, Parashtruesi, *Kërkesë për rishikimin e vendimit*, 23 shkurt 2019, publike.

² KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 1.

³ KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 4.

⁴ DHSK, shpërndarë përmes postës së brendshme elektronike nga Njësia për Administrimin e Gjykatës, 25 shkurt 2019.

⁵ KSC-BC-2019-02, F00002, Kryetarja, *Vendim për caktimin e një gjykatësi të vetëm në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit për rishikimin e vendimit të Administratores të datës 18 shkurt 2019 në lidhje me ndihmën juridike*, 26 shkurt 2019, publik.

mars 2019.⁶ Më 4 mars 2019, gjykatësi i vetëm urdhëroi Administratoren që të bëjë parashtrimin e përgjigjes deri më 7 mars 2019.⁷

4. Më 28 shkurt 2019, Administratorja dorëzoi dokumentet përkatëse, të përfshira në 19 shtojcat konfidenciale.⁸ Më 6 mars 2019, Administratorja parashtrroi përgjigjen ndaj kërkesës për rishikim ("Përgjigjja e Administratores e datës 6 mars 2019").⁹

II. VENDIM

5. Gjykatësi i vetëm në vijim:

URDHËRON Parashtruesin që kundërpërgjigjen e mundshme ndaj përgjigjes së Administratores të datës 6 mars 2019, ta parashtrojë brenda pesë (5) ditësh nga data e marrjes së përkthimit në gjuhën shqipe të Përgjigjes së Administratores të datës 6 mars 2019; dhe

RIKUJTON se, në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Parashtruesi mund t'i bëjë parashtrimet në gjuhën shqipe.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i vetëm

⁶ KSC-BC-2019-02, F00003, Gjykatësi i vetëm, *Urdhër Administratores për dërgimin e dokumenteve lidhur me vendimin KSC/REG/IOR/1632, 27 shkurt 2019, publik.*

⁷ KSC-BC-2019-02, F00005, Gjykatësi i vetëm, *Urdhër për Administratoren në lidhje me parashtrimin e përgjigjes, 4 mars 2019, konfidencial.*

⁸ KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale, 28 shkurt 2019, publik me shtojca konfidenciale.*

⁹ KSC-BC-2019-02, F00006, Administratorja, *Përgjigje ndaj kërkesës për rishikim të vendimit të Administratores në lidhje me ndihmën juridike të datës 18 shkurt 2019, 6 mars 2019, konfidenciale.*

E enjte, 7 mars 2019
Në Hagë, Holandë.